

VENDIM
Nr. 662, datë 4.10.2006

**PËR HEQJEN NGA ARMATIMI E PËRDORIMI I NJË PJESE TË MJETEVE
LUFTARAKE TË AVIACIONIT TË FORCAVE TË ARMATOSURA, SI DHE PËR
ASGJËSIMIN OSE ÇMONTIMIN E SHITJEN E TYRE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutes dhe të pikave 7 e 11 të nenit 14 të ligjit nr.8671, datë 26.10.2000 “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit dhe të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Heqjen nga armatimi dhe përdorimi i mjeteve luftarake të aviacionit të Forcave të Armatosura, të armatimit të tyre dhe të municioneve, sipas tabelave, që i bashkëlidhen këtij vendimi.
 2. Mjetet luftarake të aviacionit, armatimi i tyre dhe municionet e përcaktuara në pikën 1 të këtij vendimi, të asgjësohen ose të çmontohen dhe të shiten në formë skrapë, sipas dispozitave ligjore, ndërsa pjesët, që kanë vlerë përdorimi tjetër nga ajo e përdorimit në Forcat e Armatosura, t’u nënshtrohen procedurave për administrimin dhe tjetërsimin e pronës shtetërore.
 3. Ngarkohet Ministri i Mbrojtjes të nxjerrë udhëzimin përkatës për përcaktimin e kriterëve teknike dhe të procedurave të asgjësimit, çmontimit a tjetërsimit të mjeteve luftarake të aviacionit, të armatimit të tyre dhe municioneve, të hequra nga armatimi dhe përdorimi.
 4. Të ardhurat, që do të realizohen, të trajtohen sipas vendimit nr.432, datë 28.6.2006 të Këshillit të Ministrave “Për krijimin dhe administrimin e të ardhurave, që krijojnë institucionet buxhetore”.
 5. Ngarkohet Ministria e Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha